


VENDIM
I ORTAKUT DHE ADMINISTRATORIT
TË VETËM TË SHOQËRISË
GUXO LLC

Nr. 1, Datë 08.07.2025

Unë i nënshkruari, Florian Tafa, shtetas shqiptar, lindur më 14.09.1981, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I109140480 banues në *"3760 Newport Bay Drive, Alpharetta, Georgia, 30005"* duke vepruar në cilësinë e Ortaku dhe Administratorit të vetëm, të shoqërisë **GUXO LLC**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar, regjistruar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit të shtetit të Texas (Teksas), SH.B.A., me Numër Identifikimi të Punëdhënësit 33-4323242, me seli në adresën: *"215 Rruga Brazos, #2212 Austin, Texas, 78701-78701"*, (**"Shoqëria"**), këtu e më poshtë:

VENDOSA

1. Të themelojë dhe regjistrojë në Shqipëri, Degën e shoqërisë GUXO LLC me seli në adresën: *"Rruga "Myslym Shyri", Ndërtesa MATR, Apartamenti 5, Tiranë, Shqipëri"*;
2. Emri (subjekti dhe tregtar) i Degës së Shoqërisë GUXO LLC në Shqipëri do të jetë **"Epika"**;
3. Dega do të themelohet me një afat të pacaktuar nga regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri;
4. Dega do të ketë të njëjtin objekt aktiviteti me Shoqërinë GUXO LLC dhe mund të ushtrojë çdo aktivitet tjetër të ngjashëm, të dobishëm, të lidhur ose të nevojshëm për arritjen e ushtrimit të aktivitetit të saj. Aktiviteti ekonomik kryesor i Degës do të jetë: *"Marketing digjital, si dhe çdo aktivitet tjetër i lidhur me këtë. Gjithashtu, dega do të ketë të drejtë të kryejë edhe çdo aktivitet tjetër ekonomik të lejuar në Republikën e Shqipërisë në përputhje me rregullimet përkatëse."*;
5. Drejtuesi dhe përfaqësuesi ligjor i Degës do të jetë **Z. Florian Tafa**, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, më 14.09.1981, banues në *"3760 Newport Bay Drive, Alpharetta, Georgia, 30005"*, me letërnjoftim me nr. personal I109140480, emëruar në detyrë për një afat të pacaktuar dhe me kompetenca të plota për të përfaqësuar Degën në Shqipëri të GUXO LLC;
6. I jap të drejtën dhe autorizoj **Z. Gjergji Gjika**, shtetas shqiptar, lindur më 11.01.1982, në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, mbajtës i Pasaportës me nr. BJ8777986 dhe nr. personal I20111142D, **Znj. Evis Jani**, shtetase shqiptare, lindur më 30.09.1976, në Tiranë, Shqipëri, banuese në Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit me nr. personal H65930101H, dhe **Z. Ergys Hasani**, shtetas shqiptar, lindur më 19.05.1993, në Berat dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J30519062T, për të kryer dhe ndjekur, veçmas ose bashkërisht, të gjithë veprimet dhe procedurat për regjistrimin e Degës në Shqipëri të Shoqërisë GUXO LLC, në



Qendrën Kombëtare të Biznesit, apo për kryerjen e çdo lloj veprimi, hartimin dhe nënshkrimin e çdo dokumenti të nevojshëm për regjistrimin, kryerjen e çdo veprimi tjetër apo hartimin dhe nënshkrimin e çdo lloj dokumenti dhe depozitimin përpara çdo autoriteti, institucioni, enti apo agjencie publike apo private, përfshirë përgatitjen, nënshkrimin, depozitimin dhe tërheqjen e akteve apo dokumenteve. Çdo veprim i kryer nga përfaqësuesit e përmendur më sipër në kufijtë e treguar në këtë akt do të konsiderohet i miratuar dhe i vlefshëm.

Ky vendim hartohet dhe nënshkruhet në 2 kopje në gjuhën shqipe.

Nënshkruar sot më 08.07.2025.

GUXO LLC
ORTAKU DHE ADMINISTRATORI I VETËM

FLORIAN TAFA

FLORIAN TAFA

(nënshkrimi)